



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:237928

Datë: 10.10.2024

Numri i dokumentit: 06283056

PPP.nr.123/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të përmbarimit, sipas propozimit për përmbarim të kreditorëve F S, F H, F M, F K, F H, të gjithë nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, kundër debitorit të përmbarimit Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, lidhur me përmbarimin e dokumentit përmbarues aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec, C.nr.852/23, të datës 03.06.2024, i plotfuqishëm nga data 26.06.2024, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 05.07.2024, i lejuar me urdhrin për përmbarim P.nr.6171/24, i datës 09.07.2024, të përmbaruesit privat B.B, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të përmbarimit, jashtë seancës gjyqësore, më datë 10.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, ashtu që SHFUQIZOHET urdhri i përmbaruesit privat B.B nga Peja, P.nr.6171/24, i datës 09.07.2024, sa i përket kërkesës së kreditorëve që në emër të shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përmbarim, debitori t’ia paguajë shumën prej 84.24 euro në emër të TVSH-së prej 18%.

II. MBETET NË FUQI urdhri i përmbaruesit privat B.B nga Peja, P.nr.6171/24, i datës 09.07.2024, me të cilin është caktuar përmbarimi në bazë të dokumentit përmbarimor aktgjykimit C.nr.852/23, të datës 03.06.2024, lidhur me kompensimin në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në shumë prej 333.00 euro, me kamatë ligjore 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë me datë 28.09.2023, e deri në pagesën definitive, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës përmbarimore në shumën prej 468.00 euro.

A r s y e t i m

Organi i përmbarimit, përmbaruesi privat B.B nga Peja, ka caktuar përmbarimin sipas Urdhrin për përmbarim P.nr.6171/24, i datës 09.07.2024, në bazë të dokumentit përmbarimor

aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec me numër C.nr.852/23, të datës 03.06.2024, i plotfuqishëm nga data 26.06.2024, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 05.07.2024, kundër debitorit të përmbarimit Komuna e Rahovecit, lidhur me kompensimin në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në shumë prej 333.00 euro, të caktuar sipas aktgjykimit të lartpërmendur të kësaj gjykate.

Kundër urdhrin me të cilin është caktuar përmbarimi, debitori, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kontestuar urdhrin për lejimin e përmbarimit, me pretendimin se ndaj të njëjtit është ushtruar mjetin e jashtëzakonshëm, përkatësisht revizionin në Gjykatën Supreme të Kosovës. Më tej ka shtuar se kreditorët veç e veç kanë ushtruar propozim për përmbarim, me çka janë duke i keqpërdorur të drejtat. Gjithashtu, e kundërshton edhe pjesën e propozimit mbi shpenzimet e procedurës përmbarimore, ku kreditori ka kërkuar edhe 18 % të TVSH-së.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datë 02.08.2024, duke cekur se në bazë të nenit 213 të LPK-së revizioni i paraqitur nuk është pengesë për ekzekutimin e aktgjykimit. Sa i përket shpenzimeve në emër të TVSH-së prej 18%, i njëjti është bazuar në Ligjin për tatim në vlerën e shtuar.

Gjykata pas shqyrtimit të propozimit të kreditorëve, urdhrin për caktimin e përmbarimit, prapësimin të debitorit, përgjigjes në prapësim, si dhe shkresave tjera të lëndës ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e shfuqizuar urdhrin pjesërisht urdhrin e përmbaruesit privat B.B P.nr.6171/24, i datës 09.07.2024, sa i përket kërkesës së kreditorëve që në emër të shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përmbarim debitori t’ia paguajë shumën prej 84.24 euro në emër të TVSH-së prej 18%, me arsyetimin se këto shpenzime nuk i përkasin dispozitivit të vendimit gjyqësor me të cilin me të cilin është paraqitur propozimi për përmbarim e as nuk janë të parapara në Tarifën e Odës së Avokatëve për shpenzimet procedurale.

Sa i përket pikës II të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata me analizimin e propozimit për përmbarim P.nr.6171/24, i datës 09.07.2024, aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec, C.nr.852/23, të datës 03.06.2024, i plotfuqishëm nga data 26.06.2024, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 05.07.2024, ka ardhur në përfundim se sipas këtij aktgjykimi, debitori është i detyruar që kreditorëve në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në shumë prej 333.00 euro, me kamatë ligjore 8% duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë më datën 28.09.2023, e deri në pagesën përfundimtare. Gjykata vlerëson se dokumenti përmbarues, aktgjykimi C.nr.852/23, i përmbush të gjitha kushtet ligjore konform LPP-së nenit 22 par.1 nënpar.1.1, nenit 23 par.1 dhe nenit 24 par.1 në të cilët përcaktohet se (neni 22 par.1 nënpar.1.2) *”Dokumente përmbaruese janë: 1.2. vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbarues”, neni 23 par.1 ”Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore.....”, neni 24 par.1 “Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie*

apo bërje, është i përmbarueshëm po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare. Ndërsa në nenin 27 par.1 përcaktohet se "Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit". Nga kjo rezulton se vendimi në fjalë është titull përmbarimor sepse i njëjti ka marrë formën e prerë, ka të përcaktuar kreditorët dhe debitorët, kohën e përmbushjes së detyrimit, dhe shumën e përmbushjes. Për këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi që ta refuzoj prapësimin e debitorit sepse pretendimet e se aktgjykimi i cili është objekt i përmbarimit është në fazën e shqyrtimit të mjetit të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme të Kosovës, për gjykatën është pretendim i pabazuar sepse gjykata në procedurën përmbarimore kujdeset se a është bërë propozimi për përmbarim dhe a është lejuar përmbarimi në bazë të dokumentit përmbarues siç kërkohet me dispozitat ligjore në fuqi. Në procedurën përmbarimore organi përmbarues e cakton dhe zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumenteve të besueshme dhe dokumenteve përmbaruese, siç është aktgjykimi C.nr.852/23, të datës 03.06.2024, i plotfuqishëm nga data 26.06.2024, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 05.07.2024.

Nga ajo që u tha më lartë, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 22 par.1 nënpar.1.1, neni 23 par.1, 24 par.1, neni 27 par.1, neni 71,73 neni 77 par.1, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenit 382 par.1 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.123/2024, me datë 10.10.2024

Bashkëpunëtor profesional
Armond Omega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.